



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1140/5 Prot.

Tiranë, më 23.04.2025

VENDIM

Nr. 24 Datë 23.04 2025

**“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE PËR
KURSIN PROFESIONAL TË UDHËRRËFYESIT TURISTIK TË
SPECIALITETIT TË VEÇANTË-MODULI RAFTING, NË UNIVERSITETIN E
SPORTEVE TË TIRANËS”**

Mbështetur në nenin 49, të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e UST -së neni 43, në VKM nr. 692 datë 05.10.2026 "Për miratimin e Rregullores për kriteret për paisjen me certifikatën për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat përgjegjësitë dhe kodi i Etikës", në Udhëzimin nr. 517 datë 24.01.2017 "Për akreditimin e programeve për edukimin profesional në vazhdim", në Vendimin e Senatit Akademik nr. 26 datë 17.05.2019 "Mbi miratimin e Rregullores së organizimit dhe funksionimit të kursit profesional të certifikimit të udhërrëfyesit të specialiteteve të veçanta", në Vendimin e B.A. nr. 68 datë 17.10.2023 "Mbi një ndryshim dhe shtesë në Vendimin e B.A. nr.35 datë 21.10.2019 "Mbi miratimin e rregullores financiare dhe shpërndarjes së të ardhurave të UST" dhe miratimin e trajtimit financiar të stafit administrativ të angazhuar në mbarëvajtjen e QTFV dhe realizimin e modulit Raftin në UST", në Vendimin e B.A. nr. 43 datë 31.10.2024 "Për miratimin e rregullores së brendshme për Administrimin Financiar, Kontabilitetin dhe Kontrollin në Universitetin e Sporteve të Tiranës" neni 7, pika 5, gërma "d", në shkresat e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit nr. 832 Prot., datë 12.03.2025 të "Kërkesë për ndryshimin e shpërndarjes së të ardhurave për kursin profesional të Udhërrëfyesit Turistik të Specialitetit të Veçantë Moduli Rafting" dhe shkresën nr. 832/1 Prot., datë 25.03.2025 "Argumentim mbi kërkesën për ndryshimin e shpërndarjes së të ardhurave për kursin profesional të Udhërrëfyesit Turistik të Specialitetit të Veçantë Moduli Rafting", të Vendimit të Senati Akademik nr 47 datë 07.04.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e dates 23.04.2025

V E N D O S I :

1. Të miratojë që shpërndarja e të ardhurave për kursin profesional të Udhërrëfyesit Turistik të Specialitetit të Veçantë - Moduli Rafting, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, të bëhet në koston reale të programit dhe jo sipas përqindjeve të përcaktuara në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 43 datë 31.10.2024.

2. Të ardhurat e mbetura pas zbritjes së kostos për realizimin e këtij moduli, të kalojnë për llogari të Universitetit të Sporteve të Tiranës
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti I Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI

